



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.324, datë 20.10.2023

PËR

“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR  
PROKURORIN MARJETA ZAIMI”

Bazuar në nenet 149/a, germa “e”, 149/ç të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164 pika 8, nenin 189 pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 8 të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Marjeta Zaimi, si pedagoge e jashtme në Shkollën e Magjistraturës, për lëndën “I mituri dhe viktima”, me një ngarkesë prej 96 orë pune në semestrin e parë, viti akademik 2023 – 2024.
2. Të njoftohen për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe prokurori Marjeta Zaimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 20.10.2023.

KRYETAR

Alfred Bala

